**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Kuvendi**

**P R O J E K T L I G J**

**Nr.______, datë_________**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8246, DATË 1.10.1997, "PËR INSTITUTIN E INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8246, datë 1.10.1997, "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 1

Instituti i Integrimit të të Përndjekurve (IIP), si institucion shtetëror në varësi të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ka për qëllim të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.".

**Neni 2**

Neni 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 3

Struktura dhe organika e IIP-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ndërsa rregullorja e funksionimit të institutit miratohet nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
Drejtori i IIP-së emërohet dhe shkarkohet nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, pasi merret mendimi i shoqatave të të përndjekurve.”.

**Neni 3**

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 4

Për të siguruar veprimtarinë e tij, IIP-ja mbështetet në një fond buxhetor, i cili miratohet si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

IIP-ja mund të sigurojë burime financiare edhe nëpërmjet donacioneve e projekteve të ndryshme nga donatorë vendas e të huaj ose edhe nga çdo burim tjetër i ligjshëm.

Të gjitha donacionet ose të ardhurat e tjera të ligjshme, që i vijnë IIP-së, përdoren vetëm për qëllimet, për të cilat është krijuar ky institut.

IIP-ja informon dhe i raporton ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të gjitha të ardhurat financiare që sigurohen nga cilido burim.”.

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E T A R I**

**ILIR META**